



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe dispozitave të neneve 17 dhe 40 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe dispozitave të neneve 19 dhe 34 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 04 mars 2024, miratoi këtë,

VENDIM PËR LIRIM NGA PAGESA

Neni 1

Miratohet lirimi nga pagesa për pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe Zjarrfikësve të Kosovës për shërbimet që ofrohen në Qendrën Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe Institucionet tjera shëndetësore që janë në menaxhim të Komunës së Podujevës.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-400/04-0015813/24
Podujevë, datë; 04 mars 2024

